

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-32

M 84.

Piro Misha



novelë

814-22
1184.

Piro Misha

2692



Për mallin
e tokës

novelë

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

PROLOG

Nëpër terrin e natës ai kaptoi murin dhe doli në korridorin që të shpinte në fortesën e brendshme. I veshur i tëri me të zeza, me kokën mbuluar me një kapuç të zi, ai ishte bërë një me natën. Bëri nja dhjetë hapa në shtegun e ngushtë të korridorit dhe pastaj befas ngriu në vend, i ngjeshur pas murit, aty ku terri ishte më i dendur, derisa kaluan të dy patrullat e rojave. Atëherë hodhi përmbi murin anësor një çengel të veshur me rrobë, të lidhur me një litar të hollë mëndafshi dhe u kacavor me të shpejtë. Mblodhi pastaj me nxitim litarin dhe u zhduk matanë.

Ishte trupvogël dhe i lehtë, ndaj s'ndihej fare kur vraponte. Nja njëzet hapa më tej shquheshin hijet e rojave, por askush s'e vuri re. Një re e madhe kishte zënë hënën. Vrasësi bëri të ngjiste ca shkallë të vogla, që të shpinin në sheshin e vrojtimit, po zhurma e hapave të një patrulle e kruspullosoi prapë në qoshen e murit, nën shkallë, të ngjashëm me një gur, me një boshllëk errësire të asaj nate pa hënë. Sa hap e mbyll sytë, ai u gjend sipër në shesh. Jo shumë hapa larg ishte një nga

portat e qytetit dhe aty një rojë, që po rrinte mbështetur pas murit duke vërshëlyer nëpër dhembë. Roja mbështeti për një grimë heshtën pas murit, hapi gojën dhe u shtriq, duke i mbyllur vetëm një çast sytë, aq sa duhej që thika e vrasësit t'i ngulej në fyt. Vrasësi hapi ngadalë portën. Drita e pishtarit zhvendosi hijet nëpër mure. Në anën tjetër të portës nuk kishte rojë. Vrasësi kaloi pa u ndier rrugët e zbrazura të qytetit, gjersa mbërriti te një ndërtesë e madhe, që zotëronte gjithë sheshin qendror. Një ndriçim i argjendtë lau për pak kohë rrugën, pastaj u zhduk prapë. Ai ndaloi para portës së madhe të drunjtë, me shufra hekuri të kryqëzuara dhe trokiti lehtë tri herë.

— Kush është?

— Hape!

— Kush është?

Ai s'u përgjigj.

Porta u hap ngadalë, fare pak dhe ai vërshoi brenda. Me njëren dorë i futi rojës thikën në fyt. me tjetrën i zuri gojën. Roja vdiq në këmbë. Por atë çast një portë tjetër e vogël anësore u hap dhe prej saj doli një ushtar tjetër, me sytë ende të skuqur nga gjumi...

— Do...

Fjala i mbeti në fyt. Vrasësi u vërvit menjëherë, po megjithatë ai, para se të vdiste, pati kohë të lëshonte një britmë habie, inati e tmërri. Menjëherë në dhomat përreth u dëgjuan zhurma, britma alarmi, vringëllima armësh. Vrasësi u sul i dëshpëruar nëpër shkallë, hapi një portë dhe u hodh në errësirë, aty ku duhej të ndodhej shtrati. Po një dorë e kapi nga prapa. Ai u përpëliti, u

përpoq të qëllonte me thikë. Qe e pamundur. Ai mendoi me tmerr se po binte i gjallë në dorë. Bëri një sforcim të tmerrshëm, e liroi dorën që mbante thikën dhe e nguli me tërë fuqinë në mes të barkut të vet. Një grimë më pas mbaroi në mes të gulsheve të gjakut.

K R E U I

Martini nuk nxitonte. Ecte ngadalë, sikur të donte ta zgjaste sa më shumë atë kënaqësi që i sillte ngrohtësia e rrezeve të diellit. Ishte një diell i largët, një shëmbëlltyrë e zbehtë e diellit të verës, e megjithatë nën të, dheu, ende i lagur nga shiu që kishte rënë gjatë gjithë ditës së djeshme, dukej sikur avullonte. Ishte një aromë dehëse, shenjë e sigurt se pranvera kishte hyrë. Martini ndaloi pak para portës së vogël të kopshtit. Mendoj se gjithçka po merrte jetë, jo vetëm gjallesat, bimët e drurët, por madje edhe gurët, shtëpitë, rrugët e qielli kishin ndryshuar. Pranvera ishte stina e shpresave.

Në dhomë ishte mugëtirë, ndaj s'e vuri re menjëherë plakun që rrinte i ulur në një fron në qoshen më të errët të dhomës. Ndoshta s'e vuri re edhe nga që s'priste të gjente njeri tjetër në shtëpi, veç Marjanës, së shoqes. E pa vetëm pas disa çastesh, kur u hap deriçka e dhomës ngjitur, nga hyri Marjana, e bashkë me të disa rreze drite që ndriçuan qoshen ku po rrinte plaku.

— Më fal, se s'të pashë, ma mori mendjen

pranvera! Eja, ulu këtu, të pimë nga një gotë verë! — tha Martini.

I ulur në stol, plaku (Pal Mëtrasa quhej dhe ishte i ungji i Marjanës) dukej shtatimët, por, kur u çua në këmbë, trupi i tij eshtak befaz sikur u zgjat jashtë mase.

— More vesh gjë? Si është puna e asaj që ndodhi mbrëmë? Është shenjë e sigurt, luftën e kemi pranë! Ti si thua?

Zërin e kishte paksa të ngjirur nga nata.

Martini s'iu përgjigj menjëherë. Diçka u këput brenda tij, iu bë sikur ato fjalë i futën në trup gjithë ftohtësinë e dimrit. Kishte gënjyer veten kur kishte pandehur se po vinte pranvera. Dimri i kishte ngritur pusi tamam këtu brenda në shtëpinë e tij.

— Isha andej nga qendra. Që të gjithë këtë histori kanë në gojë dhe secili e ka nga një hamendje. Po mua, të them të vërtetën, nuk më duket ndonjë shenjë kaq ogurzezë. Se mos është hera e parë që rreken të vrasin një njeri, qoftë ai edhe komandanti i qytetit. Pastaj vetëm nga fytyra e nga veshja s'e merr dot vesh kurrë se kush e ka dërguar vrasësin, apo jo?

— Veç ama dhe ta mendosh të futet aq thellë në qytet, pa pyetur fare për jetën e vet, s'është gjë e zakonshme. Dhe mos harro në ç'kohë jemi! Që kur vdiq Gjergji... — Plaku heshti një çast, po Martini s'e la të vazhdonte. I foli gati vrazhdë. Çdo tipar i fytyrës së tij kishte ndryshuar, sikur befaz çdo vijë e saj të kishte pësuar një përthyerje të shurdhër.

Zëri i Marjanës i mbërriti me zor në vesh,

i largët, qortues. Ajo po e thërriste në emër:

— Martin!

E dinte se tani duhej t'i kërkonte të falur plakut, t'i thoshte se s'e mbante dot veten kur dëgjonte të flitej në këtë prag pranvere vetëm për luftë e për turq. Unë të them ja ujku, ti më thua ja gjurmët! Të gjithë e dinin se herët a vonë turku do të vinte, po disave u pëlqente ta mbanin veten me shpresa. Ngriti sytë dhe pa plakun. Ai dukej i qetë, si të mos kishte vënë re asgjë.

Martini atë çast e ndjeu veten vërtet fajtor. Pse, s'e e dinte ai që Palë Mëtrasa ishte një njeri që kurrë s'dilte menjëherë aty ku donte? Me të duhej të kishe durim. Ai i vërtiste e i vërtiste fjalët, të fuste e të nxirrte në një mijë e një vogëlsira e historira dhe tamam atëherë kur ty të dukej vetja i humbur brenda asaj djerrine fjalësh, ai dilte në krye.

— Isha qëpari me Jako qorrin. I qe mbushur mendja burrit top se në këtë punë ka dorë turku. Sot, këtu nuk ka njeri që t'i njohë turqit më mirë nga ai. Ka qenë shtatë vjet në ushtrinë e tyre, jo shaka! — Plaku heshti për t'u mbushur me frymë, siç dukej s'fliste dot gjatë se lodhej. Martini pati përshtypjen se në të vërtetë ai vazhdonte një kuvendim nën zë dhe fare papritur fillonte të fliste fort, që të dëgjohej nga të tjerët. Ndërkohë vuri ré Marjanën, të ulur në një fron të ulët, që po merrej me një punë dore.

— Dy qytete të lira kanë mbetur në gjithë Arbërinë, turqit do të rreken t'i lajnë hesapet me ne këtë verë. Pse të mos e besosh ti se më

parë ata do të dërgojnë njerëz të vrasin prijësit tanë? Pa dëgjo, ç'po më thoshte qëpari Jako qorri. Turqit na paskan njerëz të veçantë që i stërvitin vetëm për vrasje, njerëz që s'kthehen të gjallë, pa e mbaruar punën që u është ngarkuar. Në e quajmë dot punë edhe vrasjen, hë! Kur s'kanë shteg tjetër, vrasin veten, po gjer më sot s'ka ndodhur të kapin ndonjë të gjallë. Paska kohë që ata qenkan bërë tmerri i sundimtarëve të vegjël andej nga Azia, po këtu te ne, në Evropë, s'para u është ndier zëri. Jako qorri po më thoshte që ata besojnë se, pasi ta kenë shpënë në vend urdhrin që kanë marrë, do të shkojnë drejt e në xhenet, siç i thonë turqit paraajsës së tyre. Më parë atyre u thoshin ashashinë dhe për këtë Jako qorri më rrëfeu një histori ca si të çuditshme, që e kishte dëgjuar andej nga Turqia.

Plaku ndaloi prapë e zgjati kokën sikur të donte të shihte diçka në rrugë.

— Po Jako qorri ç'ka dashur në Turqi? — pyeti Marjana.

Zëri i saj u end për disa çaste i brishtë, i ngrohtë, gjersa dalngadalë u grimcua e humbi nëpër qoshet e odës dhe vetëm atëherë, kur ishte zhdukur edhe jehona e tij më e largët, kur në dhomë s'ndihej më asnjë zhurmë, plaku filloi të fliste:

— Jako qorri? Ai... po, ai ka qenë shtatë vjet të tërë ushtar te turku. Është nga një vend andej nga Jugu i Arbërisë, një vend që turqit e kanë pushtuar që kur ishte akoma Gjergji gjallë. Turqit e patën marrë mercenar, me zor. Kadri Sulejmani ia vunë emrin. Dhe e mbajti këtë emër nja shtatë vjet të mirë, brodhi e luftoi

me të nëpër viset e turkut, gjersa e solli era dhe e hodhën në viset tona të luftonte kundër Gjer-gjit. Atëherë ai u hodh në anën tonë... Është bur-rë trim, — shtoi plaku më në fund. Martinit iu bë sikur ai foli shpejt e shpejt, si ta kishte bezdi të jepte hollësiat e bredhjeve të Jako qorrit. Ve-tëm fjalët e fundit i shqiptoi ngadalë, shkoqur, duke i theksuar një nga një, si të donte ashtu t'i veçonte nga të tjerat.

Martini ngriti gotën me verë dhe për një grimë pa në të fytyrën e plakut përballë, disi të përçudnuar, të lëngët, gati-gati të qelqtë.

— S'ka shumë vjet që diku matanë dheut të turqve, në një luginë të ngushtë, mes malesh të larta e të thepisura, na ishte një sundimtar, i quajtur Abaudin. Vetëm atë copë luginë kishte, po megjithatë e mbanin si një nga njerëzit më të pasur e më të frikshëm të kësaj bote. Rruga për në trojet e tij ishte e vështirë, e ruajtur nga të gjitha anët nga ca kështjella të forta dhe asnjeri s'kishte sosur dot aty që ta shihte si ishte e si nuk ishte. Thoshin pastaj se në atë luginë ai kishte ngritur një kopsht paradisi, o perëndi, kopsht të fshehtë, ku s'shkelte njeri, me pemë e zogj nga më të rrallët dhe me një dru molle të artë, ku në vend të kokrrave vareshin gurë të çmuar.

Plaku pushoi prapë për të marrë frymë. Fy-tyra e tij ishte shumë e qetë. Martini mendoj me vete se ai duhej të ishte mjaft i moshuar. Për-herë i qe dukur çudi se si qe e mundur që një njeri të jetonte aq gjatë në një kohë të tillë luf-tërash. Ndoshta kjo qe edhe arsyeja që plaku ishte gjithnjë aq i qetë. Ai i kishte larë me kohë